

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Tre dekada drejtues të SHIK-SHISH, meritat dhe akuzat
ADRESA	https://piranjat.al/politike/tre-dekada-drejtues-te-shik-shish-meritat-dhe-akuzat-i106508
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 20:30:12 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 20:21:48 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	f099ecebec83ad53b1534a7222d8f4f8c58d563b43676537cb8a6432401ce3f0
TEKSTI	2d8eb0d475345b813b3a53c2fdc0a990c00c124e6a21b5c00ad7d37da6ca002
PAMJA	b50f7859b4147980ddaec341e85e6e3501b136e0b4561131845cb86bc1eec6d3

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	eb09e2d6722d4a3c2d63db4f348916692c07620177201847be49def408f841ed
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	81d9502dee89498020984867f5c9e7803768541a0034d6fb041c0efcf168cb37
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/eb09e2d6722d4a3c2d63db4f348916692c07620177201847be49def408f841ed

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash:

meritat dhe

ndërmjet
mënyrë të
pashmangshme
me drejtuesit e

**Gjëmë e
madhe,**

kërkuar një
reformim të
thellë të

**drejt
"Qytetit"**

dorëheqje";
qytetarët
kanë vijuar

**"Skënderbej"
kërkohet**

qytetarëve në
sheshin
"Skënderbej"

**plagjiaturën
e ministres**

penal në
SPAK pas
publikimit të
investigimit

POLITIKE

Tre dekada drejtues të SHIK-SHISH, meritat dhe akuzat

Piranjat Përditësimi i fundit 28 Shtator 2026, 22:21



Historia e shërbimit inteligjent shqiptar pas rënies së komunizmit lidhet në mënyrë të pashmangshme me drejtuesit e tij në më pak se tre dekada.

Institucioni që fillimisht njihej si SHIK dhe më pas mori emrin SHISH, është një nga strukturat më të rëndësishme të sigurisë së shtetit.

Sipas vetë SHISH, drejtori i institucionit përgjigjet për mbledhjen, analizimin dhe shpërndarjen e informacionit të inteligjencës, ndërsa duhet të mbrojë burimet dhe metodat e punës nga ndërhyrjet e paautorizuara.

Pas viteve '90 shumica e drejtorëve të SHISH janë shkarkuar dhe vetëm tre prej tyre janë dorëhequr, të cilët janë Irakli Koçollari, Visho Ajazi Lika dhe Helidon Bendo.

Ndërkohë, faqja e Shërbimit Inteligent Shqiptar, ka hequr fotografinë e Vlora Hysenit nga seksioni "Rreth nesh", (Drejtuesit e SHISH ndër vite), ku shfaqen të gjithë ish-drejtorët e këtij institucioni.

Por në kategorinë "Media", vazhdon të ketë të publikuar të gjithë veprimtarinë e Hysenit si shefe të SHISH dhe takime me homologë të saj dhe përfaqësues ndërkombëtarë.


Irakli Koçollari: drejtori i parë dhe çështja e dosjeve

Irakli Koçollari ishte drejtori i parë i SHIK-ut pas vendosjes së pluralizmit, nga gushti 1991 deri në qershor 1992.

Më pas u largua nga drejtimi i institucionit. Emri i tij do të rikthehej në qendër të vëmendjes disa vite më vonë.

Në mars 1996, Koçollari u arrestua së bashku me ish-ministrin e Brendshëm Vladimir Hysi në një çështje që lidhej me asgjësimin e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit.

Koçollari u dënua me 6 vite burg, ndërsa Vladimir Hysi me 18 muaj. Koçollari doli nga burgu në vitin 1997 (tazirat dhe amnistia).





Bashkim Gazidede: SHIK-u në vitet e trazirave

Në qershor 1992, drejtimin e SHIK-ut e mori Bashkim Gazidede. Ai qëndroi në detyrë deri më 9 prill 1997, në kulmin e krizës së rëndë politike dhe sociale që pasoi rënien e skemave piramidale.

Gazidede u largua nga drejtimi në prill 1997 dhe iku nga Shqipëria. Në vitet që pasuan, mbi periudhën e drejtimit të tij u ngritën akuza të shumta politike dhe publike për përdorimin e SHIK-ut ndaj kundërshtarëve politikë dhe për shkelje të rënda gjatë trazirave të viteve '90.

Pas largimit të Gazidedes, për një periudhë të shkurtër drejtimin e institucionit e morën Astrit Kodra dhe më pas Arben Karkini, ky i fundit qëndroi nga maji, deri në gusht 1997.

Të dy konsiderohen pjesë e periudhës tranzitore të SHIK-ut pas krizës së vitit 1997.



Fatos Klosi: ristrukturimi dhe ndryshimi i emrit

Në gusht 1997, drejtimin e shërbimit e mori Fatos Klosi. Ai ishte drejtori i parë i institucionit pasi emri u ndryshua nga SHIK në SHISH dhe qëndroi në detyrë deri në gusht 2002.

Mandati i Klosit u shoqërua me përpjekje për ristrukturimin e shërbimit pas krizës së vitit 1997 dhe me një ndryshim të raportit të institucionit me politikën.

Por edhe ai u bë objekt akuzash. Në vitin 2002, Kuvendi ngriti një komision hetimor për akuzat lidhur me veprimtarinë e SHISH-it dhe drejtorit të tij, Fatos Klosi.

Dokumenti zyrtar i Kuvendit konfirmon ekzistencën e këtij hetimi parlamentar.

Klosi u largua nga drejtimi më 7 gusht 2002. Pas Klosit, Petrit Myftari drejtoi përkohësisht institucionin për disa muaj, deri në nëntor 2002.

Kujtim Hysenaj: një mandat i ndërprerë nga vdekja

Në nëntor 2002, në krye të SHISH erdhi Kujtim Hysenaj, një diplomat me karrierë të gjatë.

Hysenaj qëndroi në detyrë deri në janar 2005, kur ndërroi jetë. Për këtë arsye, largimi i tij nuk ishte shkarkim apo dorëheqje.

Pas vdekjes së tij, për një periudhë të shkurtër funksionin e drejtuesit e ushtroi zëvendësdrejtori Ylli Alushi.





Bahri Shaqiri: shtatë vite në krye dhe një shkarkim politik

Bahri Shaqiri është një nga drejtuesit me mandatin më të gjatë pas vitit 1991. Ai drejtoi SHISH-in nga janari 2005 deri në gusht 2012.

Në gusht 2012, presidenti i sapozgjedhur Bujar Nishani dekretoi shkarkimin e tij dhe emërimin e Visho Ajazi Likës në krye të shërbimit.

Në atë kohë, raportimet theksonin se shkarkimi ishte propozuar nga kryeministri Sali Berisha dhe miratuar me dekret presidencial.

Në kohën e largimit të tij, ambasadori amerikan në Tiranë, Alexander Arvizu, e vlerësoi publikisht punën e Shaqirit dhe kërkoi që pasardhësi i tij të vazhdonte në të njëjtën rrugë.

Në të njëjtën periudhë u raportua se pala amerikane kishte vlerësuar transformimin dhe punën e SHISH-it pas vitit 1997, veçanërisht në luftën kundër terrorizmit.



Visho Ajazi Lika: pesë vite dhe një dorëheqje

Visho Ajazi Lika mori drejtimin e SHISH-it në gusht 2012. Ai qëndroi rreth pesë vjet në krye të institucionit dhe u lirua nga detyra në tetor 2017. Raportimet e kohës e paraqitën dorëheqjen si të dhënë me vullnetin e tij. Gjatë mandatit të tij, SHISH u përfshi në disa debate publike, përfshirë pretendime për përgjime të politikanëve dhe çështjen e pajisjeve IMSI catcher.

Ai u paraqit edhe para një komisioni parlamentar si dëshmitar lidhur me këtë çështje.

Helidon Bendo: largim për studime

Pas dorëheqjes së Ajazi Likës, Helidon Bendo mori drejtimin e SHISH-it, fillimisht në funksion të komanduar dhe më pas si drejtor. Ai qëndroi në krye nga fundi i vitit 2017 deri në dhjetor 2022.

Largimi i tij ishte i ndryshëm nga rastet e mëparshme. Në dhjetor 2022, Bendo dha dorëheqjen.

Kryeministri Edi Rama deklaroi se ai po vijonte studimet në SHBA dhe më pas Bendo u angazhua si këshilltar për reformën në institucionet e sigurisë.



Vlora Hyseni: rasti që rikthen vëmendjen

Në shkurt 2023, Vlora Hyseni u emërua në krye të SHISH-it me propozim të kryeministrit dhe dekret të presidentit. Karriera e saj para emërimit ishte zhvilluar kryesisht në strukturat e inteligjencës së Kosovës, ku kishte mbajtur edhe pozicionin e zëvendës drejtores së Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë.

Në qershor 2021, ajo ishte larguar nga ky institucion; autoritetet kosovare në atë kohë nuk dhanë publikisht një arsye të detajuar për largimin, duke iu referuar bazës ligjore dhe detyrimit të saj për ruajtjen e informacionit të klasifikuar.

Më 22 shtator 2026, pas kërkesës së SPAK, GJKKO caktoi ndaj saj masën “arrest në shtëpi” dhe pezullimin nga detyra.

Sipas SPAK, hetimi lidhet me akuzat për “përkrahje të autorit të krimit” dhe “zbulim të akteve ose të dhënave sekrete”.

Pas zhvillimit, Presidenti Bajram Begaj dekretoi shkarkimin e saj dhe drejtimi i SHISH-it u delegua përkohësisht te Elvis Lila, drejtori i Departamentit Operacional. /Faktoje/

Galeria fotografike ()





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.